



Inicijativa za REKOM  
Initiative for REKOM  
Иницијатива за РЕКОМ  
Nisma për KOMRA  
Pobuda za REKOM

## KOMUNIKATË E NISMËS KOMRA

### Keqpërdorimi i organizatave joqeveritare në kontekstin e ballafaqimit me të kaluarën

**21.06.2012.**

Disa media të veçanta në BeH dhe përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republika Srpska me këmbëngulje transmetojnë informacione të pasakta mbi procesin KOMRA, kurse mbi nismëtarët dhe avokuesit e Nismës flasin me gjuhën e urrejtjes dhe përhapin qëndrime të cilat janë në kundërshtim të plotë me parimet themelore të drejtësisë tranzicionale, me çka e keqpërdorin organizatën, në emër të së cilës flasin. Në botimin e gazetës “Press” të datës 20. 06.2012, kanë shkruar edhe një hap më tutje. Shumë haptas, me përkrahjen e fuqishme të gazetarëve të kësaj gazete, Branko Todoroviqi, kryetar i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republika Srpska e përbaltë profesorin Zdravko Grebo, regjisorin e teatrit Dino Mustafiçin, gazetaren Xhenana Karup Drushko, nismëtarën e Nismës Natasha Kandiçin dhe Pierr Mirelin, drejtor i Departamentit të KE për Ballkanin Perëndimor. Përkundër raportimeve publike pa asnjë të metë të kompanive të huaja të revizionit, Todoroviqi vazhdon të transmetojë pohime të pavërteta – se projekti ka dështuar dhe se donacionet po shpenzohen pa destinacion dhe, midis të tjerash, edhe në honoraret e avokuesve. Është e vërtetë se avokuesit nuk kanë honorare dhe punën e tyre e bëjnë në mënyrë vullnetare të nxitur nga bindja e tyre lidhur me vlerën e projektit dhe ideja e themelimit të KOMRA-s.

Tek është fjala për qëndrimet e përfaqësuesve të organizatës së cekur, është për brengosje moskuptimi i rolit të organizatave joqeveritare në procesin e ballafaqimit me të kaluarën. Në tekstin e përmendur të gazetës “Press”, Branko Todoroviqi e transmeton qëndrimin se projekti KOMRA “saboton secilën përpjekje të institucioneve vendore që më në fund të vënë një pikë lidhur me ngjarjet nga vitet nëntëdhjetë”, në mënyrë që, në të njëjtin rast, të shpreh brengën edhe për faktin se “njerëzit udhëheqës të KOMRA-s përpiqen për të ndalur formimin e komisioneve shtetërore për vërtetimin e të vërtetës mbi ngjarjet e luftës së fundit”. Pak më herët, nga e njëjta organizatë është lansuar vërejtja se KOMRA është rrezik potencial për përsëritjen e agresionit në BeH. Në tryezën e rrumbullakët të Komisionarit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, të mbajtur në Sarajevë në muajin mars të vitit 2012, përfaqësuesja e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RS, Aleksandra Letiq i ka bërë thirrje komisionarit Thomas Hammarbergut dhe institucioneve të tjera ndërshtetërore të heqin dorë nga angazhimet për themelimin e KOMRA-s, “sepse themelimi i KOMRA-s do të ishte edhe një agresion ndaj BeH”.

Le ta shfrytëzojmë këtë rast që edhe njëherë të vërtetojmë se profesionalisht dhe në pikëpamje të aktivitetit jemi të vendosur të mos lejojmë që institucionet shtetërore dhe disa organizata joqeveritare, siç është Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RS, të vënë pikën në ngjarjet e viteve nëntëdhjetë. Do të angazhohemi që trashëgimia jonë e rëndë të mbetet libër i hapur, i shkruar mbi faktet e vërtetuara, dhe për gjeneratat e ardhshme. E theksojmë se me gjithë zemrën dhe dijen angazhohemi për themelimin e Komisionit Ndërshtetëror Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi të gjitha krimet e luftës, thellësisht të bindur se KOMRA nuk ka alternativë. E tërheqim vërejtjen lidhur me dëmin, të cilin mund ta pësoj përpjekja aktuale e institucioneve shtetërore në BeH në ndërtimin e strategjisë së drejtësisë tranzicionale nga angazhimi i përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RS, i cili avokon vënien e pikës në ngjarjet e luftës. E falënderojmë Komisionin Evropian dhe institucionet e tjera, të cilat e kanë njohur potencialin e Nismës KOMRA në ndërtimin e paqes e të pajtimit në rajonin e ish Jugosllavisë.

**Zdravko Grebo**, profesor i Fakultetit Juridik në Sarajevë, avokues i vendosur i Nismës KOMRA

**Xhenana Karup Drushko**, gazetare, avokuese e vendosur e Nismës KOMRA

**Dino Mustafiq**, regjisor i teatrit, avokues i vendosur i Nismës KOMRA

**Natasha Kandiç**, avokuese e të drejtave në të vërtetën dhe drejtësinë dhe e Nismës KOMRA.